



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

RELACION

PËR

PROJEKTUDHËZIMIN “PËRCAKTIMI I RREGULLAVE PËR NGRITJEN, CAKTIMIN DHE NJOFTIMIN E VENDNDODHJES SË QENDRAVE TË VOTIMIT DHE PËRGATITJEN E HARTËS SË NJËSISË SË VETËQEVERISJES VENDORE PËR ZGJEDHJET.

Neni 12, paragrafi 4, e ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, përcakton se Komisioni Rregullator (Rregullatori) është organi kompetent për miratimin e akteve me karakter normativ në fushën e zgjedhjeve dhe vendosjen e rregullave për zgjedhjet.

Në përmbushje të kompetencës së parashikuar në nenin 20, paragrafi 1, germa “a”, të Ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Komisionit Rregullator i paraqitet për shqyrtim dhe miratim projektvendimi “Për caktimin e rregullave për ngritjen, caktimin dhe njoftim e vendndodhjes së qendrave të votimit dhe përgatitjen e hartës së njësisë së qeverisjes vendore për zgjedhjet”.

Neni 46 paragrafët 1 dhe 2, i ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, përcakton se lista e zgjedhësve hartohet për çdo zonë qendre votimi dhe përmban të gjithë zgjedhësit që kanë vendbanimin e regjistruar në RKGJC në atë zonë qendre votimi. Përfshirja e zgjedhësit në listë bëhet mbi bazën e kodit të vendbanimit. Një zonë qendre votimi ka jo më pak se 300 dhe jo më shumë se 1000 zgjedhës me vendbanim në territorin e saj.

Neni 50, paragrafi 3 i ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, përcakton se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, mbikëqyr procesin e hartimit të listave të zgjedhësve, administrimin e zonave të qendrave të votimit dhe numrit të zgjedhësve për çdo qendër votimi. KQZ-ja i kërkon informacion Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile dhe njësisë të qeverisjes vendore. Për shkeljet e konstatuara dhe për mosdhënie të informacionit, KQZ-ja u vendos sanksione drejtuesve të institucioneve përgjegjëse, në përputhje me këtë Kod.

Neni 52, paragrafi 6 i ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, përcakton se Kryetari i bashkisë të paktën një herë në javë, si dhe sa herë i kërkohet nga KQZ-ja raporton për zbatimin e përcaktimeve të bëra në këtë nen. Mënyra e komunikimit me KQZ-në dhe masa administrative e gjobës, që zbatohet ndaj kryetarit të bashkisë në rast mosraportimi, dhe ekzekutimi i gjobës përcaktohen me vendim të KQZ-së.

Neni 62, i ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar parashikon Caktimin e zonave dhe vendndodhjes së qendrave të votimit.



Neni 93 i ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar parashikon vendndodhja e qendrave të votimit, selive të KZAZ-ve dhe Vendeve të Numërimit të Votave.

Neni 108 i ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar përcakton se në çdo rast, kur ka zgjedhës të regjistruar, sipas pikës 6 të këtij neni, të cilët kanë vështirësi hyrjeje në mjedisin e qendrës së votimit, caktimi i qendrës së votimit dhe organizimi i saj bëhen në mënyrë të tillë që të garantojnë hyrjen e lirë për këtë kategori zgjedhësish. Në rast se kjo është e pamundur, në përputhje me vendimet dhe me shpenzimet e KQZ-së, kryetarët e njësisve të qeverisjes vendore caktojnë personel apo pajisje ndihmëse për të garantuar hyrjen e lirë.

Neni 109, paragrafi 1 i ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar përcakton se qendra e votimit organizohet në një mënyrë të tillë që të lehtësojë procesin e votimit dhe të sigurojë fshehtësinë e votës. Qendrat e votimit kanë një organizim tip, sipas përcaktimit me vendim të KQZ-së.

Qëllimi i këtij projektvendimi është përcaktimi i rregullave që do të ndiqen nga organet njësisë së qeverisjes vendore, për caktimin e zonave dhe vendndodhjes së qendrave të votimit, në përputhje me parashikimet e nenit 46 paragrafi 1 dhe 2, nenit 50 paragrafi 3, nenit 52, nenit 62, nenit 63, nenit 93, nenit 108 paragrafi 7 dhe nenit 109 paragrafi 1, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Projektvendimi ka për objekt përcaktimin e rregullave për njoftimin e KQZ lidhur me caktimin, ngritjen dhe vendodhjen e qendrave të votimit, kryerjen e njoftimit të zgjedhësve, përgatitjen e hartës së njësisë së qeverisjes vendore për zgjedhjet, ku përcaktohen zonat e qendrave të votimit, adresat dhe lloji i objektit ku janë vendosur qendrat e votimit.

Neni 1 dhe neni 2 reflektojnë qëllimin, objektin e projektvendimit dhe përkufizime për zonën e qendrës së votimit, për qendrën e votimit dhe qendrën e votimit në institucione të posacme dhe për hartën e njësisë së vetqeverisjes vendore.

Neni 3, parashikon kriteret për caktimin dhe ngritjen e qendrave të votimit, kriteret që duhet të plotësojnë mjediset për tu ngritur qendrat e votimit, rastet kur KQZ mund të caktojë qendra votimi në ndërtesa private si dhe mjediset e ndaluara për ngritjen e qendrave të votimit.

Neni 4, përcakton kriteret që duhet të përmbushen në rastin e bashkimmit të qendrave të votimit, (kriteri i numrit të zgjedhësve dhe kriteri i largësisë).

Neni 5, përcakton kriteret teknike dhe pajisjet (sipërfaqe jo më të vogël se 30 m²; afërsia me qendrën gjeografike të zonës së qendrës së votimit, ndriçim të mjaftueshëm, katet e para të objekteve, të jetë e pajisur me me tavolina, karrige apo pajisje të tjera) dhe masat që duhen marrë Kryetari i Njësisë së Qeverisjes Vendore për qendrat e votimit.



Neni 6, përcakton kompetencën Kryetarit të Njesisë së Vetqeverisjes Vendore për përgatitjen e hartës së njesisë dhe kriteret teknike, dërgimin e saj në KQZ si dhe kompetencën e KQZ-së për krijim dhe përditësimin e hartës së zonave të qendrave të votimit .

Neni 7, parashikon informacionin që Kryetari i Njesisë së Vetqeverisjes Vendore përcjell në KQZ për zgjedhësit me aftësi të kufizuara.

Neni 8, përcakton mënyrën, afatet dhe procedurat për shpalljen dhe njoftimin e vendndodhjes së qendrave të votimit si dhe mënyrën e komunikimit të kryetarit të Njesisë së Vetqeverisjes Vendore me KQZ-në për raportimin mbi njoftimin më shkrim të zgjedhëse sipas përcaktimeve të nenit 52 të Kodit Zgjedhor.

Neni 9, përcakton rastet kur mund të ndryshoj vendndodhja e qendrës së votimit nga KQZ, në përputhje me afatet e vendosura nga Kodi Zgjedhor.

Neni 10, përcakton afatet për dërgimin e listës së zgjedhësve në KQZ, dërgimin e informacionit mbi numrin e çdo QV-je, vendndodhjen e tyre, numrin përkatës të zgjedhësve në listën e zgjedhësve sipas modelit të përcaktuar nga KQZ. (bashkelidhur vendimit).

Neni 11, parashikon sanksionet administrative ndaj Kryetarit të Njesisë së Vetqeverisjes Vendore në rast të refuzimit të zbatimit të urdhërimeve të KQZ-së në lidhje me qendrat e votimit si dhe në rast mosraportimi për njoftimin me shkrim të zgjedhësve.

Neni 12 dhe neni 13 parashikojnë shfuqizimin e Vendimi Nr.1, datë 12.12.2012 “Për mënyrën e ngritjes dhe caktimit të vendndodhjes së qendrave të votimit dhe përgatitjen e hartës së njesisë së qeverisjes vendore për zgjedhjet”, hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, dhe detyrimin e publikimit të tij në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Ana TENOLLI – Drejtorja e Komisioneve dhe Materialeve Zgjedhore
Madalena KOJA – Drejtorja Juridike dhe e Dokumentacionit Zgjedhor
Ylli MERKAJ – Sekretar i Përgjithshëm

